



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:223138
Datë: 22.11.2023
Numri i dokumentit: 04956104

Ka. nr. 314/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Tahir Sylaj Oil SH.P.K., si person juridik, me seli në Pejë, për kundërvajtje nga neni 7 par. 8, 9 dhe 10 sanksionuar me nenin 19 par. 15 pika 15.1 dhe 15.2 të Ligjit Nr. 08/L- 018 për Tregti me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga i pandehuri Tahir Sylaj Oil SH.P.K., si person juridik, përfaqësuar nga drejtori Arsim Tahirsylaj, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.1175/22, të datës 31.07.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga i pandehuri Tahir Sylaj Oil SH.P.K., si person juridik, përfaqësuar nga drejtori Arsim Tahirsylaj, me seli në Pejë, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.1175/22, të datës 31.07.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Inspektorati i Tregut, me numër të Ref. 19/2022, të datës 17.10.2022, dhe me numër të protokollit 6291-19, me aktgjykimin K.nr. 1175/22, të datës 31.07.2023, të pandehurin Tahir Sylaj Oil SH.P.K., si person juridik, me seli në Pejë, e ka shpallë përgjegjëse sepse:

- nga dita e pa caktuar e deri më dt.10.10.2022 në pikën e karburantit „TAHIRSYLAJ OIL SH.P.K.,-njësia në Pejë në rrugën „UÇK,, nr.97, me qëllim që të mashtroi blerësit si konsumatorë

përfundimtarë lidhur me cilësinë ka shitur naftë-dizel për automjete në atë mënyrë që, me rastin e inspektimit nga Inspektorët e Inspektoratit të Tregut të MTI-së në bashkëpunim me Trupën Inspektuese „Sierra Lab., SH.P.K., pas marrjes dhe testimit të mostrave të produktit dizel dhe testimit të nesërmen me dt.11.10.2022 nga ana e Laboratorit Testues „Kosova –Lab., SH.A., ka rezultuar se produkti nuk ishte konform me parametrat minimale të pikës së ndezjes 55 °C (pesëdhjetepesë gradë celsius) të përcaktuara me neni 7 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës por, pikën e ndezjes e kishte nën parametrat minimale-25 °C (njëzete pesë gradë celsius), ndërsa me datë 12.10.2022 pas marrjes dhe analizimit edhe të një mostre për verifikim të cilësisë për arsye se e pandehura kishte argumentuar se ishte furnizuar me derivat të ri, përsëri kishte rezultuar se produkti Dizel ishte jo konform UA.01/2017. Me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 13 par.2 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës, andaj në bazë të nenit 19 par. 8 pika 8.1. të ligjit të lartë cekur dhe e ka dënuar me dënim me të holla në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €. Dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa nëse gjoba nuk paguhet vullnetarisht brenda afatit të lartë cekur do të inkasohet detyrimisht konform Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Është obliguar i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale paushalle të paguaj shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) €, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimi nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

Me aktvendimin K.nr.1175/22 të datës 07.08.2023, është korrigjuar aktgjykimi K.nr.1175/22 i datës 31.07.2023, ashtu që në fillimin e pasusit të katërt të dispozitivit, respektivisht në rreshtin e parë të pjesës dënuese ku është shënuar me numra 15.000 € (pesëdhjetëmijë) €, duhet të jetë 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €. Në pjesë tjera aktgjykimi në fjalë mbetet i pa ndryshuar.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur, ankesë i pandehuri Tahir Sylaj Oil SH.P.K., si person juridik, përfaqësuar nga drejtori Arsim Tahirsylaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës së kundërvajtjes, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, në të cilën veç tjerash thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, nga neni 139 par.1.9, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërrthënës me vetveten dhe arsyet e dhëna në të. Ky pretendim argumentohet në aspektin numerik është i pa qartë se çfarë vlere është kurse me shkronja ka shënuar vlerën tjetër, vlere këto të ndryshme njëra me tjetrën. Edhe pse i pandehuri është i bindur se ky duhet të jetë vetëm një gabim i natyrës teknike të gjykatës i shkaktuar për shkak të volumit të madh të punës që e kanë. Ndërkaq vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston në rrethanat se gjykata duke mos i dhënë rëndësinë e duhur provave të dorëzuara në gjykatë dhe atë dokumentet e furnizimit me derivate nga i pandehuri, ka rezultuar me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, nga faturat e furnizimit vërtetojnë se i pandehuri gjatë kohës kur pretendohet të ketë kryer veprën kundërvajtëse është furnizuar nga furnitorët e brendshëm dhe atë nga kompania Lab Oil dhe bazuar në këto fakte këtu i pandehuri nuk mund të jetë përgjegjës për plasim në treg të produktit me cilësi të dobët përderisa produktin nuk e ka prodhuar vet dhe as nuk e ka importuar atë. I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ose ta ndryshoj dhe të nxjerr aktgjykim lirues.

Kolegji i kësaj gjykate, duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktgjykimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur nga i pandehuri Tahir Sylaj Oil SH.P.K., si person juridik, përfaqësuar nga drejtori Arsim Tahirsylaj, nuk është e bazuar andaj edhe refuzohet.

Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të mbrojtjes së drejtorit Arsim Tahirsylaj, dëshmisë së dëshmitares – Inspektorës së rastit Eljesa Beqiri, Procesverbaleve të përpiluara nga Inspektorët e Tregut me numër 00109/22 të datës 10.10.2022 dhe 00112/22 të datës 12.10.2022, raportit të inspektimit me numër 537/2022 – TI-M të datës 11.10.2022 të trupës inspektuese “Sierra Lab” dhe raportin e dytë të inspektimit me numër 549/2022 – TI-M të datës 12.10.2022, Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të pandehurit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë gjeti se i pandehuri është fajtor ngase ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë pretendimet e të pandehurit se nafta blihet në këtë cilësi nga tregtarët me shumicë dhe se nuk preket nga askush edhe sikur të jenë të vërteta nuk e lirojnë nga përgjegjësia, ngase me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MTI) me numër 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës shprehimisht është paraparë minimumi i cilësisë së dizelit të cilët naftëtarët e licencuar të cilët e shesin e që në rastin konkret minimumi i pikës së ndezjes që duhet të jetë 55 grad celsius e që në rastin konkret nuk është plotësuar nga rezultatet e testimit të kryera në laboratorin e licencuar nga MTI.

Kjo gjykatë i vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse e vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, as shkelje të ligjit material, siç pretendohet në ankesë, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërrënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje kundërvajtëse. Pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë seancës gjyqësore dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë me një aktvendim të veçantë e ka rregulluar gabimin teknik i cili është përmirësuar me aktvendimin korrigjues me numër dhe datë të cekur më lartë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje kundërvajtëse nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji procedurës kundërvajtëse siç pretendohet në ankesë. Kjo për faktin se veprimet e të pandehurit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës kundërvajtëse për të cilën i njëjti është shpallur përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen apo përgjegjësinë kundërvajtëse të pandehurit. Gjithashtu kolegji i kësaj gjykatë ka shqyrtuar edhe çështjen përkitazi me vendimin për dënim dhe vlerësoj se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimi të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka shqiptuar dënimin duke pas parasysh të gjitha rrethanat konform dispozitës së nenit 35 dhe 31 të LK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.


Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,

Ka.nr. 314/2023, të datës 21.11.2023

ZYRTARJA LIGJORE

Rrezarta Bala



TAČNOST KOPIJE
RUKOVODIOČ SUDSKE PISARNE

KRYETARI I KOLEGJIT
Ferit Osmani